



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:068106

Datë: 23.11.2021

Numri i dokumentit: 02429740

2021:079917

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm Penal, me gjyqtaren e vetme gjykuese Mimoza Shabani, me procesmbajtës Arton Cokli, në çështjen penale kundër të pandehurit V.B. me vendbanim në rrugën “...” në Ferizaj, për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm e evidentuar me numër: PP/II.nr.504/2021 e datës 23 Prill 2021, duke vendosur lidhur me aprovimin e marrëveshjes së ndërmjetësimit Nr.185/21 e datës 03 Nëntor 2021 lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj, mes të pandehurit V.B. në një të anë dhe të dëmtuarve: A.H., A.V. dhe A.S. në anën tjetër, në bazë të nenit 358 par. 1 nën par. 1. 3 të KPP-së, si dhe nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, më datë 23 Nëntor 2021 mori këtë:

A K T V E N D I M

- **APROVOHET**, marrëveshja me Nr.185/21 e datës 03 Nëntor 2021 lidhur në Qendrën e Ndërmjetësimit në Ferizaj, mes të pandehurit V.B., në një të anë dhe të dëmtuarve A.H., A.V. dhe A.S. në anën tjetër.
- **HUDHET**, Aktakuza Prokurorisë Themelore në Ferizaj – Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr. 504/2021 e datës 23 Prill 2021 dhe **PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurit V.B. i lindur me datë 18.05.1998, me nr. personal ..., me vendbanim rrugën “...” në

Ferizaj, për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar ne kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.1 të KPRK-ës.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Ferizaj-Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën e evidentuar me numër: PP/II.nr. 504/2021 e datës 23 Prill 2021, ka akuzuar të pandehurin V.B. me vendbanim në rrugën “...” në Ferizaj, për shkak të veprës penale pengimi i personit zyrtar ne kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.1 të KPRK-ës.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, me pajtimin e palëve në procedurë dhe në bazë të nenit 323 të KPP-ës dhe nenit 8 par.1 dhe par.2 dhe nenit 14 par.1 dhe par.2 të Ligjit për Ndërmjetësim, vendosi që lënda penale të dërgohet në Qendër për Ndërmjetësim, ndërsa me datën 03 Nëntor 2021, nga Qendra e Ndërmjetësimit në Ferizaj është arritur marrëveshja Nr.185/21 e datës 03 Nëntor 2021, në mes palëve në procedurë respektivisht të pandehurit V.B. në njërën anë dhe të dëmtuarve A.H., A.V. dhe A.S. në anën tjetër.

Palët e dëmtuara në këtë çështje penale kanë hequr dorë nga ndjekja penale ndaj të pandehurit si dhe nga realizimi i kërkesës pasurore juridike, pasi që u pajtuan që mosmarrëveshjen ta mbyllin me një kërkim falje si dhe i pandehuri ka premtuar se nuk do të përsërisë me raste të tilla në të ardhmen.

Gjyqtarja e vetme gjykuese, pas shikimit dhe vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetësim, konstatoj se palët pa ndonjë kërcënim dhe me vetë dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje të zgjidhet me ndërmjetësim dhe nuk kanë kontestuar asnjë nga pikat e marrëveshjes së ndërmjetësimit, andaj vendosi që ta aprovoj marrëveshjen si të bazuar.

Në bazë të nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim, marrëveshja e ndërmjetësimit në datën e aprovimit nga gjykata përkatësisht nga data 22 Nëntor 2021, do ta ketë fuqinë e titullit ekzekutiv.

Nga sa u tha më lartë, në bazë të nenit 358 par. 1 pika 1.3 të KPP-ës, si dhe nenit 15 par.1 të Ligjit për Ndërmjetësim nr.06/L-009, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
Departamenti i Përgjithshëm Penal
2021:079917 i datës 23 Nëntor 2021

Praktikanti: Arton Cokli

Gjyqtarja: Mimoza SHABANI

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 3/tre/ ditëve nga dita vijuese pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2021:068106
Datë: 23.11.2021
Numri i dokumentit: 02429740